



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme –
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate

POLICIMI NË KOHËN E PANDEMISË: Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës Janar - Dhjetor 2020

2020



Titulli i raportit: **Policimi në kohën e pandemisë:
Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës
Janar - Dhjetor 2020**

Përpiluesi: **Major Sadik SHEFQETI**
Sektori për Planifikim Strategjik
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Toger Fahrije LUTFIU
Sektori për Planifikim Strategjik
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Mbikëqyrur: **Nënkolonel Nazmija BAŠOVIĆ**
Shef i Sektorit për Planifikim Strategjik Drejtoria për Planifikim Strategjik
dhe Çështje Ligjore

Aprovon: **Kolonel Reshat MALIQI**
Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

z. Dejan JANKOVIĆ
Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë për Resurse

Autorizon: **z. Samedin MEHMETI**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Lektor: **znj. Leonora FEJZULLAHU - RUHANI**
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

**Përkthim në gjuhën
angleze dhe serbe:** **Sektori i përkthimeve**
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Dizajni grafik: **z. Çajup KAJTAZI**
Webdizajner
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Policia e Republikës së Kosovës
www.kosovopolic.com

☎ 192

✉ info@kosovopolic.com

POLICIMI NË KOHËN E PANDEMISË:

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS

JANAR - DHJETOR 2020




TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
PARANDALIMI I PËRHAPJES SË KORONAVIRUSIT COVID-19.....	8
SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE.....	11
SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR.....	13
PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMET E RËNDA, KRIMI EKONOMIK&KORRUPSIONI, TERRORIZMI, EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI.....	15
NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE.....	19

LISTA E SHKURTESAVE

BIMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DShSh	Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
GNMI	Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve
KA	Komisioni i Ankesave
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PK	Policia e Kosovës
PRIMS	Sistemi informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë së Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QKTGj	Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut
QS	Qendra Studentore
SIPK	Sistemi i Integruar Informativ i Policisë së Kosovës
SHGPK	Shoqata e Grave e Policisë së Kosovës
UD	Ushtruesi i detyrës
UO	Urdhër Operativ



z. Samedin MEHMETI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Mesazhi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

Policia e Kosovës vazhdon të kryejë funksionin e saj të shërbimit dhe mbrojtjes së qytetarëve me të gjitha kapacitetet e saj. Ne jemi të përkushtuar në vazhdimësi për shërbim me profesionalizëm ndaj qytetarëve të vendit, siguria e të cilëve është interesi ynë, e cila është e arritshme duke punuar në partneritet me të gjithë pjesëtarët e komunitetit, për të ofruar siguri dhe për të zgjidhur problemet që ndikojnë në sigurinë publike.

Çdo vit, Policia e Kosovës përpilon raport vjetor për të përmbledhur realizimin e detyrave dhe objektivave të parapara me planin vjetor të punës. Ky raport rishikon arritjet, nxjerr në pah aktivitetet dhe vlerëson se si institucioni ynë po përparon në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave.

Viti 2020 për Policinë e Kosovës ishte një vit jo i zakonshëm, duke pasur parasysh faktin që pandemia COVID 19 ka ndikuar edhe në aspektin e planifikimit dhe angazhimit, marrë parasysh sfidën e rrezikut të infektimit të vet zyrtarëve tanë, ku fatkeqësisht kemi pasur një numër të konsiderueshëm zyrtarëve policorë të infektuar, nga të cilët, disa edhe me pasoja fatale.

Mirëpo këto sfida kemi arritur t'i ballafaqojmë me një aktivizim të pandërprerë dhe përkushtim profesional për të mos lejuar që pandemia të ndikoj në fushat të cilat bien në kompetencën tonë siç janë luftimi i krimit të organizuar, krimeve ekonomike, korrupsionit, trafikimit me narkotik e të tjera. Për realizimin e objektivave dhe qëllimeve, puna

jonë ka qenë kryesisht e bazuar në Planin Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2016- 2020 dhe në përputhje me ligjet dhe aktet tjera nënligjore.

Gjatë këtij viti ne kemi vazhduar rrugën në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve policore si një përpjekje afatgjate për të arritur të gjitha nivelet e një institucioni profesional, të besueshëm dhe transparent. Kjo arritje është bërë përmes mbështetjes materiale, trajnimeve, monitorimit, këshillimit dhe forcimit të përgjegjësisë dhe mbikëqyrjes.

Duke e pasur parasysh rëndësinë madhore që kemi për një jetë dhe vend të sigurt të secilit qytetar, ne kemi vazhduar dhe ngritur bashkëpunimin me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare, paraprirë edhe me marrëveshjeve të lidhura ndër-institucionale.

Gjatë kësaj periudhe kohore për të cilën po raportohet nuk ka munguar as mbështetja e vazhdueshme e partnerëve tanë ndërkombëtare, të cilët kanë ofruar donacione të ndryshme posaçërisht me pajisje të ndryshme.

Policia e Kosovës do të vazhdojë të ndryshojë dhe të zhvillohet me qëllim të përshtatjes me çdo risi, nevojë dhe detyrë të re që paraqitet. Prandaj do të jemi parimor, të mbështesim punonjësit tanë në punën e tyre, duke çmuar dhe vlerësuar rezultatet e treguara, në mënyrë që të jenë të vullnetshëm dhe plotë motiv, për një shërbim sa më të denjë ndaj qytetarit.

Prandaj, falënderoj përzemërsisht secilin punonjës të Policisë së Kosovës për rezultatet e arritura.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 9,169 punonjës, prej të cilëve 8,176 janë zyrtarë policorë, ndërsa 993 staf civil. 84.91% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.09% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.60% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 15.40% i takojnë komuniteteve tjera etnike.

Numri i veprave penale të raportuara ka shënuar rënie për 9.43%.

Numri i personave të arrestuar ka shënuar rënie për 0.87%.

Aksidentet në trafikun rrugor kanë shënuar rënie për 14.51%

Persona të vdekur në aksidentet e trafikut rrugor kanë shënuar rënie për 28.31%

Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje për 8.04%.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit brenda Policisë, përmes Drejtorisë së saj për Shërbime Shëndetësore (DShSh), janë: (a) organizuar ligjërata në temë se si të mbrohemi nga koronavirusi; (b) janë vendosur 800 posterë “Jo frikë por kujdes të shtuar për COVID-19”, si dhe (c) janë shpërndarë 10,887 broshura “Koronavirusi dhe shëndeti mendor”.

Në zbatimin e UO për gatishmëri dhe reagim kundër Koronavirus COVID-19 janë angazhuar gjithsej 6500 zyrtarë policorë apo 79.06% e personelit të uniformuar të Policisë, të cilët kanë qenë të angazhuar në:

- a) patrullimin parandalues 24/7, fillimisht me 2 ndërrime, në orarin 12 orësh;
- b) ofrimin e sigurisë në Qendrën Studentore si karantinë e detyrueshme dhe Klinikën Infektive me prezencën e saj 24/7;
- c) 166 pika të kontrollit në hyrje/dalje të 63 zona komunale në karantinë;
- d) 71,745 pika tjera të kontrollit;
- e) në inspektimin e 12,880 qytetarëve të cilët gjenden në vetizolim në shtëpi;
- f) 2,326 përcjellje policore;
- g) 5,994 asistime inspektorëve komunalë, si dhe
- h) 485 asistime të shërbimeve shëndetësore.

Për mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë, Policia e Kosovës:

a) ka hapur 1,760 raste sipas nenit 249-250 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj 2,980 personave, prej të cilëve 1,235 persona kanë qenë të arrestuar dhe 253 persona të ndaluar;

b) ka shqiptuar 108,082 fletëparaqitje në bazë të Ligjit nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës;

c) ka dhënë 65,009 vërejtje nga Policia për qytetarët, si dhe

d) ka plotësuar 73,226 forma të kundërvajtësve, të cilat i janë dërguar inspektoratit Sanitar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë dezinfektuar të gjitha objektet policore dhe janë shpërndarë:

- a) 37,696 maskë mbrojtëse kundër virusit;
- b) 28,170 dorëza mbrojtëse kundër virusit;
- c) 170 veshje mbrojtëse kundër virusit;
- d) 137 litra alkool 70% dhe 3,771 dezinfektues 100ml.

Përkundër angazhimit të madh në parandalimin e përhapjes së koronavirusin në Polici, brenda kësaj periudhe raportuese janë infektuar 790 zyrtarë policorë me virusin COVID-19, prej tyre 13 punonjës të Policisë kanë vdekur, 3,037 punonjës të Policisë kanë qenë në vetizolim, ndërsa nga ana e personelit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore pranë Policisë, janë bërë 2,273 gjurmime epidemiologjike brenda Policisë.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 154 operacione, 151 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 43 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, 3,082 refuzime të hyrjes dhe 479 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës, janë shqiptuar 611 gjoba në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit.

Policia e Kosovës është vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 118 komunikata, janë publikuar 170 aktivitete policore, 365 raporte 24-orësh; revista e Policisë “Mbrojtësi”, si dhe aplikacioni i Policisë “Lajmëro Policinë”

Policia e Kosovës ka identifikuar 420 punonjës të saj, të cilët kanë sëmundje me risk të lartë ndaj koronavirusit dhe të cilët janë liruar nga ardhja në punë dhe u është rekomanduar qëndrimi në shtëpi. Policia e Kosovës, përmes DShSh-së, iu ka ofruar në vazhdimësi përkrahje të nevojshme këtyre zyrtarëve.



Raste	
Viti 2019	Viti 2020
43,668	40,759



Vepra penale	
Viti 2019	Viti 2020
30,259	27,404



Persona të arrestuar	
Viti 2019	Viti 2020
13,782	13,661



Persona të ndaluar	
Viti 2019	Viti 2020
4,732	4,780



Grupe kriminale të goditura	
Viti 2019	Viti 2020
37	28



Armë zjarri të konfiskuara	
Viti 2019	Viti 2020
1,439	1,135



Municione të konfiskuara	
Viti 2019	Viti 2020
30,438	32,747



Persona të vdekur në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
113	81



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
445,776	256,510



Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit	
Viti 2019	Viti 2020
1,005	611



Aksidente në trafikun rrugor	
Viti 2019	Viti 2020
16,222	13,868



Hyrje/dalje të personave në kufi	
Viti 2019	Viti 2020
18,145,881	11,348,216



Protesta dhe tubime të qytetarëve	
Viti 2019	Viti 2020
335	222



Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës	
Viti 2019	Viti 2020
3,029	3,082



Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës	
Viti 2019	Viti 2020
940	479

PARANDALIMI I PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19


Me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, në përputhje me planin e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19, me datën 12.03.2020, Policia e Kosovës ka hartuar UO për gatishmëri dhe reagim kundër virus COVID-19, i cili kishte për qëllim:

- a) bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale, përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e rreziqeve nga koronavirusi;
 - b) përgatitja paraprake e planeve operative policore për përballje me mjediset epidemiologjike;
 - c) krijimi dhe zhvillimi i kontakteve, bashkëpunimi dhe harmonizimi i veprimeve të përbashkëta me institucionet shëndetësore, agjencitë dhe institucionet tjera reaguese në parandalimin dhe luftimin e koronavirusit;
 - d) ofrimin e mbështetjes në aspektin e sigurisë së agjencive&institucioneve tjera shëndetësore dhe emergjente;
 - e) ngritja e vigjilencës policore për reagim të sigurt dhe efikas, gjithmonë duke i ndërmarrë masat fillimisht për siguri personale dhe të tjerëve.
- Si masë e parandalimit të përhapjes së koronavirusit në Kosovë, me datën 15 mars 2020, me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/11, është shpallur



emergjencë për shëndetin publik dhe me të njëjtin vendim, janë obliguar institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të veprojnë konform planit të reagimit kombëtar dhe të aktivizohet funksioni mbështetës emergjent 8 (FME8 shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore).

Pas shpalljes së emergjencës për shëndetin publik, me datën 18 mars 2020, me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/13, Qendra Studentore në Prishtinë ka kaluar në menaxhimin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Shëndetësisë. Me këtë vendim, çdo person i cili vërtetohet ose dyshohet se ka qenë në kontakt drejtpërdrejt me personin e sëmurë apo të dyshuar



në sëmundje nga virusi COVID-19, do të vendosen në karantinë. Për të siguruar qëndrueshmërinë e funksionimit të karantinës së detyrueshme, Ministria e Shëndetësisë ka qenë e mbështetur nga: vullnetarët, personeli i Qendrës Studentore (QS) dhe Policia, e cila ka qenë autoritet përgjegjës për ofrimin e sigurisë 24 orë të QS si karantinë e detyrueshme me 112 zyrtarë policorë, me 14 pika statike, pasi që QS përbëhet nga 8 konvikte. Përveç ofrimit të sigurisë së QS si karantinë e detyrueshme, Policia e Kosovës ka fuqizuar gjithashtu prezencën e saj në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës, në theks ofrimin e sigurisë së Klinikës së Infektivës me prezencën e saj 24/7.

Si rezultat i zhvillimeve në terren, me datën 19 mars 2020 u. d. i ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike ka marrë vendim për aktivizimin e Planit për reagimin kombëtar, me ç'rast është themeluar Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI), në përbërjen e gjerë të autoriteteve të sistemit të sigurisë së Kosovës, duke përfshirë edhe përfaqësuesin e Policisë së Kosovës.

Me aktivizimin e planit për reagim kombëtar, është mobilizuar Policia në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 dhe njëkohësisht në vazhdimin e përmbushjes së të gjitha detyrave policore të parapara me Ligjin e Policisë, planin zhvillimor strategjik 2016-2020 të Policisë dhe planin e punës së Policisë për vitin 2020, por tani në rrethana të reja, duke vepruar në mjediset epidemiologjike.

Për të siguruar koordinimin e aktiviteteve ndërinstitucionale në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Kosovë dhe njëkohësisht për të parandaluar përhapjen e virusit brenda Policisë, Policia e Kosovës ka aktivizuar Qendrën Komanduese për Menaxhim të Operacionit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) dhe në nivelin e Drejtorive Rajonale të Policisë (DRP) dhe njëkohësisht ka dërguar përfaqësuesin në:

-Komitetin për koordinim dhe vlerësim të situatës emergjente me virusin COVID-19, i themeluar nga



Ministria e Shëndetësisë, si dhe në -Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në zbatimin e UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19 janë angazhuar gjithsej 6500 zyrtarë policorë apo 79.06% e personelit të uniformuar të Policisë, të cilët kanë qenë të angazhuar në: (a) patrullimin parandalues 24/7 fillimisht me 2 ndërrime, në orarin 12 orësh; (b) ofrimin e sigurisë së QS si karantinë e detyrueshme dhe Klinikën Infektive; (c) 166 pika të kontrollit në hyrje/dalje të 63 zona komunale në karantinë; (d) 71,745 pikat tjera të kontrollit; (e) në inspektimin e 12,880 qytetarëve të cilët gjenden në vetizolim në shtëpi; (f) 2,326 përcjellje policore; (g) 5,994 asistime inspektorëve sanitarë/ komunalë, si dhe (h) 485 asistime të shërbimeve shëndetësore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në zbatimin e UO për mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë janë: (a) hapur 1,760 raste sipas nenit 249-250 të Kodit Penal të Kosovës, ndaj 2,980 persona, prej të cilëve 1,235 persona janë arrestuar dhe 253 persona janë ndaluar; (b) janë shqiptuar 108,082 fletëparaqitje (tiketa) në bazë të Ligjit nr. 07/L-006



për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe janë (c) shqiptuar 65,009 vërejtje nga Policia për qytetarët.

Pas vendimit të Qeverisë Nr. 01/10 të datës 5 korrik 2020, është ngritur bashkëpunimi ndërmjet inspektorëve sanitarë dhe inspektorateve tjera komunale me Policinë, ku për shkak të numrit të vogël të inspektorëve dhe në pamundësi të mbulimit të çdo pike, është kërkuar mbështetja e Policisë në plotësimin e formave të kundërvajtjes dhe dorëzimi i tyre Inspektorit Sanitar, i cili pastaj do të vazhdojë me shqiptimin e masave ndëshkuese. Në përputhje me këtë vendim, Policia ka plotësuar 73,226 forma të kundërvajtësve, të cilat i janë dërguar Inspektoratit Sanitar.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit brenda Policisë, Policia nëpërmjet Drejtorisë së saj për Shërbime Shëndetësore (DSHSh), ka identifikuar 420 punonjës të Policisë, të cilët kanë sëmundje me risk të lartë ndaj koronavirusit, të cilët janë liruar nga ardhja në punë dhe është rekomanduar qëndrimi në shtëpi. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë dezinfektuar të

gjitha objektet policore dhe janë shpërndarë: 37,696 maska mbrojtëse kundër virusit (21,064 maska kirurgjike dhe 13,045 maska shumë përdorimëshe, 3,487 maska artizanale dhe 100 copë maska FFPD), 170 veshje mbrojtëse kundër virusit, 28,170 dorëza mbrojtëse kundër virusit; 137 litra alkool dhe 3,771 dezinfektues 100 ml. Po ashtu, personeli i DSHSh-së kanë zhvilluar një numër të madh të aktiviteteve vetëdijesuese lidhur me parandalimin e përhapjes së koronavirusit brenda Policisë, duke filluar me:

- mbajtjen e ligjëratës me temën se si të mbrohem nga koronavirusi;
- vendosjen e 800 posterëve për parandalimin e përhapjes së koronavirusit;
- shpërndarjen e 10,877 broshurave/udhëzuesve për parandalimin e përhapjes së koronavirusit.

Përkundër angazhimit të madh në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Polici, brenda kësaj periudhe raportuese janë infektuar 790 zyrtarë policorë me virusin COVID-19, prej tyre, 13 punonjës të Policisë kanë vdekur, 3,037 punonjës të Policisë kanë qenë në vetizolim, ndërsa nga ana e personelit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore pranë Policisë, janë bërë 2,273 gjurmime epidemiologjike brenda Policisë.

SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, Policia e Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjes së objektivave policore, si rezultat i shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik në Kosovë.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 40,759 raste, prej të cilave 27,404 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 13,355 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, numri i rasteve ka shënuar rënie për 6.61%, numri i veprave penale ka shënuar rënie për 9.43% dhe numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera, po ashtu kanë shënuar rënie për 0.40%. Rënie/ngritje më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar ngritje, nga 23 në 29 ose ngritje për 26.08%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie, nga 265 në 250, ose rënie për 5.66%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar rënie, nga 4,519, në 3,863, ose rënie për 14.51%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 3,803 në 3,455, ose rënie për 9.15%;
- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar rënie, nga 171 në 148, ose rënie për 13.45%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, nga 1,915 në 2,069, ose ngritje për 8.04%.



Policia e Kosovës ka ndaluar 4,780 persona për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një ngritje për 1.01%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 13,661 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një rënie e personave të arrestuar për 0.87%.

Në operatione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 1,135 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një rënie për 21.12%, si dhe janë konfiskuar 32,747 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 është shënuar një ngritje për 7.58%.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 222 protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 vërehet një ulje e protestave dhe tubimeve për 33.73%.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e





objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2020, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteve tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç'rast janë ofruar 7,870 asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e ofrimit të asistencës për 20.50%.

Përveç angazhimit në parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Republikën e Kosovës dhe vazhdimin e përmbushjes së të gjitha detyrave

policore të parapara me Ligjin e Policisë dhe planin e punës së Policisë për vitin 2020, Policia ka vazhduar të ofrojë siguri 24 orëshe në 123 pika statike të objekteve të rëndësishme të veçantë: diplomatike, qeveritare, policore, ministore, prej të cilave 24 pika statike të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa për të gjitha objektet tjera të rëndësishme të veçantë, Policia e Kosovës kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, ku në bazë të vlerësimeve ndërmerr edhe aktivitete tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.



SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfida jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë shtete të Evropës dhe të botës. Për të adresuar këtë sfida, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të ngrihet siguria në trafikun rrugor duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në bërthamën e saj ka: (i) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, (ii) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive organizative të Policisë, pastaj ato ndërinsticionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor në kuptimin e saj më të gjerë, e cila në bërthamën e saj gjithashtu ka edhe (iii) orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar 6 plane operative në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor, janë hartuar 64 raporte analitike dhe janë realizuar 13 inspektime të infrastrukturës rrugore, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve. Ka hartuar 241 raporte/shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar tek



institucionet përkatëse. Janë realizuar 108 takime dhe pjesëmarrje në 25 emisione radio/televizive dhe 7 fushata vetëdijesuese/aktivitete/ligjërata në shkolla, të cilat kanë qenë të fokusuar në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Në kuadër të angazhimit të Policisë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, Policia ka shqiptuar 256,510 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor dhe njëkohësisht ka arritur që të zvogëlojë numrin e aksidenteve në trafikun rrugor dhe numrin e personave të vdekur dhe të lënduar në aksidente rrugore.





Brenda kësaj periudhe vërehet një rënie e numrit të:

- aksidenteve në trafikun rrugor, nga 16,222 në 13,868 aksidente, apo rënie për 14.51%;
- aksidenteve me fatalitet, nga 100 në 76 aksidente, apo rënie për 24%;
- aksidenteve me lëndime, nga 6,148 në 5,406 aksidente, apo rënie për 12.06%;
- aksidenteve me dëme materiale, nga 9,974 në 8,386 aksidente, apo rënie për 15.92%.

Fatkeqësisht, edhe përkundër përpjekjeve të mëdha të Policisë, gjatë kësaj periudhe:

- 81 persona kanë humbur jetën, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 shënon rënie për 28.31%;
- 10,243 persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019 shënon rënie për 13.63%.



Sa iu përket aktiviteteve të Komisionit për Vendasje, lidhur me kundërshtime të parashtruara për kundërvajtjet e shqiptuara nga ana e Policisë, gjatë kësaj periudhe kohore janë pranuar gjithsej 3,547 kundërshtime (ankesa), janë mbajtur gjithsej 341 seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe janë përpiluar gjithsej 3,547 vendime.

Në kuadër të angazhimeve në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 603 përcjellje të materieve të rrezikshme dhe 125 përcjellje të personaliteteve të rëndësishme, në përputhje me UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19.



¹ Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, numri i tiketave të shqiptuara për kundërvajtje në trafikun rrugor ka shënuar rënie për 42.30%. Por vlen të theksohet se përveç angazhimit në ofrimin e sigurisë së trafikut rrugor, njësitet e trafikut rrugor kanë qenë të angazhuar po ashtu edhe në luftimin dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Kosovë, me ç'rast së bashku me njësitet tjera policore, kanë shqiptuar 108,082 fletëparaqitje (tiketa) në bazë të Ligjit COVID-19, 73,226 forma të kundërvajtësve i janë dërguar Inspektoratit Sanitar dhe 65,009 vërejtje nga Policia për qytetarët.

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMET E RËNDA, KRIMI EKONOMIK&KORRUPSIONI, TERRORIZMI, EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimet e rënda, krimit ekonomik&korruptionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, janë realizuar 572 operacione, 945 bastisje dhe lokale të kontrolluara. Brenda kësaj periudhe, janë punuar në gjithsej 1613 raste, prej tyre 908 raste të reja, 495 raste të pranuar nga njësitë tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, 205 raste janë bartur nga vitet paraprake, ndërsa 5 raste janë transferuar në njësi tjera. Janë ngritur 1,050 kallëzime penale, 67 prej të cilave me kryes të panjohur, 983 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 1876 personave. Brenda kësaj periudhe raportuese, janë arrestuar 1,476 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, janë ndaluar 481 persona dhe janë goditur 28 grupe kriminale.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 64 raste, janë arrestuar gjithsej 104 persona të dyshuar dhe janë përcjellë në prokurori e gjykatë 37 kallëzime penale ndaj 88 personave të dyshuar dhe 17 fletëparaqitje

për kundërvajtje ndaj 38 personave. Prej tyre, për: (a) trafikim me njerëz janë regjistruar 20 raste, janë arrestuar 12 persona të dyshuar dhe janë ngritur 8 kallëzime penale ndaj 13 personave të përfshirë; (b) mundësim prostitucioni janë iniciuar 11 raste, janë arrestuar 32 persona të dyshuar dhe janë ngritur 12 kallëzime penale ndaj 39 personave; (c) marrje me prostitucion janë regjistruar 17 raste, janë arrestuar 36 persona dhe janë përcjellë 17 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 38 personave; (d) shërbime seksuale të viktimës së trafikimit dhe vepra të tjera të kësaj natyre janë regjistruar 16 raste, janë arrestuar 24 persona të dyshuar dhe janë ngritur 17 kallëzime penale ndaj 26 personave të përfshirë. Janë identifikuar 17 viktima dhe janë strehuar 8 viktima të trafikimit. Në kuadër të kampanjës së vetëdijesimit me moton “Mos hesht, ndal trafikimin me njerëz”, Policia ka realizuar planin operativ ‘Vjeshta 2020’ në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë operacionit janë kontrolluar 17 lokale dhe 133 persona. Nga inspektorët komunalë janë mbyllur 3 lokale dhe janë shqiptuar gjopa dhe vërejtje për mungesë të dokumentacionit të punës.



Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë iniciuar gjithsej 1,005 raste të reja, janë arrestuar 1,144 persona dhe janë përcjellë 714 kallëzime penale ndaj 938 të dyshuarve. Prej tyre, për: (a) trafikim janë regjistruar 170 raste, janë arrestuar 276 persona dhe janë ngritur 185 kallëzime penale ndaj 284 personave të dyshuar; (b) posedim të drogave janë regjistruar 802 raste, janë arrestuar 847 persona të dyshuar dhe janë ngritur 508 kallëzime penale ndaj 633 personave të dyshuar; (c) kultivim janë regjistruar 33 raste, janë arrestuar 21 persona të dyshuar dhe janë ngritur 21 kallëzime penale ndaj 21 personave të dyshuar dhe 1 rast është iniciuar për droga të tjera. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar 37 raste dhe janë arrestuar 48 persona, për kokainë janë regjistruar 38 raste dhe janë arrestuar 70 persona, për mariuhanë janë iniciuar 898 raste dhe janë arrestuar 1,005 persona, ndërsa janë iniciuar 33 raste dhe janë arrestuar 21 persona për kultivimin e bimëve të kanabisit. Janë konfiskuar: 9 kg 803.65 g heroinë; 2 kg 676.85 gr kokainë; 225.42 gr ekstazi; 256 kg 717.9 gr marihuanë, 5622 bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë janë regjistruar 183 raste, janë arrestuar 128 të dyshuar dhe janë ngritur 127 kallëzime penale ndaj 289 personave të dyshuar. Për veprën penale: (a) kundër detyrës zyrtare/korrupsionit janë regjistruar 87 raste, janë arrestuar 29 persona dhe janë ngritur 60 kallëzime penale të përcjella ndaj 144 personave të dyshuar; (b) kundër ekonomisë janë regjistruar 55 raste, janë arrestuar 86 persona të dyshuar dhe janë ngritur 42 kallëzime penale ndaj 112 personave të dyshuar; (c) kundër pasurisë, janë regjistruar 22 raste, janë arrestuar 11 persona dhe janë ngritur 29 kallëzime penale kundër 46 personave; (d) fajde, janë regjistruar 12 raste, janë arrestuar 10 persona dhe janë ngritur 7 kallëzime penale kundër 19 personave të përfshirë; (e) vepra tjera lidhur me ekonominë, janë regjistruar 7 raste, janë arrestuar 7 persona dhe janë ngritur 9 kallëzime penale ndaj 10 personave.

Në fushën e hetimit të krimeve të rënda, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 67 raste, prej të cilave 60 raste të reja dhe 7 raste të bartura nga viti paraprak.



Janë arrestuar 12 persona të dyshuar, janë ngritur gjithsej 42 kallëzime penale (për krime të rënda 38 kallëzime dhe 4 kallëzime penale për krime lufte) ndaj 446 personave të dyshuar (290 për krime lufte). Policia në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore, ka bërë hulumtimin e lokacioneve për gjetje të eshtrave të personave të zhdukur. Në 9 lokacione janë gjetur eshtra dhe është vazhduar me procedurat për eksumimin, zhvarrimin, autopsinë dhe identifikimin e eshtrave. Lidhur me krimet e luftës janë intervistuar 67 persona në cilësinë e ankuesve dhe dëshmitarëve dhe 1 person në cilësinë e të dyshuarit.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - luftës kundër këtij fenomeni, Policia e Kosovës vazhdon të adresojë në mënyrë strategjike, duke filluar prej bashkëpunimit në nivel lokal përmes Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS), Komitetet Lokale për Siguri në Publike (KLSP), e deri te implementimi i strategjisë shtetërore kundër terrorizmit dhe planit të veprimit 2018-2023, pastaj strategjisë kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023, si dhe në përputhje me doracakun e Policisë së Kosovës “Qasja proaktive policore - roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm”.



Gjatë periudhës raportuese, autoritetet e specializuara për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës kanë trajtuar gjithsej 40 raste, prej tyre 7 raste të reja dhe 33 raste të bartura. Janë arrestuar 3 persona, si dhe janë ngritur 7 kallëzime penale kundër 22 personave. Janë ndërmarrë 2 operacione, ku janë realizuar 3 plane operative. Në vazhdimësi bëhet rifreskimi i të dhënave të personave të cilët dyshohet se kanë qenë, janë apo planifikojnë të shkojnë t’iu bashkëngjiten organizatave terroriste. Policia vazhdon me patrullimet në rrjetin e internetit për të identifikuar persona me interes të Policisë, komunikata të lëshuara nga persona që përkrahin organizata të ndryshme terroriste, kërcënime të personave të ndryshëm duke u thirrur në aspektin e nxitjes së terrorizmit.



KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Policia e Kosovës ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK). Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve, autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 11,348,216 persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregojnë rënie për 37.46%; 4,440,860 mjetet motorike, që tregojnë rënie për 27.41% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe 305 trena, që krahasuar me vitin e kaluar gjithashtu tregojnë rënie për 78.92%. Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar 1,697 persona të rëndësishëm.

Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë:

Tabela nr. 1: Kontrolli i vijës së dytë.

Kategoritë	Viti 2019	Viti 2020	%
Persona	63,764	35,197	-44.80
Automjete	29,551	21,282	-27.98
Dokumente	17,838	7,625	-57.25



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 658 raste të veprave penale, 184 kundërvajtje, kanë shqiptuar 611 gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar: (a) 687 persona për vepra të ndryshme kriminale; (b) 760 persona me urdhëresa vendore; (c) 9 persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe ka ndaluar 122 persona.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 544 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 3,082 refuzime të hyrjes, 479 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 494 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 34 depërtime, 95 urdhër largime me forcë, 150 urdhër largime vullnetare dhe kanë trajtuar 1,409 kërkesa për azilkërkesë.

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar 154 operacione dhe 151 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 62 takime të punës brenda Policisë, 139 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 43 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.



NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE

Policia e Kosovës është themeluar me 6 shtator 1999, në atë kohë përbëhej nga 176 pjesëtarë të saj, tani përbëhet nga 9,169 punonjës, prej të cilëve 8,176 janë zyrtarë policorë, ndërsa 993 staf civil. Nga ky numër 84.91% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.09% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.60% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 15.40% iu takojnë grupeve tjera etnike.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të saj, Policia e Kosovës në vazhdimësi investon në kuadrat e saj, duke filluar me rekrutimin e gjeneratave të reja të policëve, ofrimin e njohurive bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e sistemeve të bazës së të dhënave, të nevojshme për kryerjen sa më efektive dhe efikase të punës policore, furnizimin me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave policore, renovimin/sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës së objekteve të Policisë, si dhe ngritjen e shëndetit dhe mirëqenies së zyrtarëve të saj.

Gjatë kësaj periudhe, gjenerata e 55-të me 427 kadet policor ka përfunduar trajnimin themelor për policinë e përgjithshme dhe ka vazhduar me trajnim praktik-fushor, ndërsa si rezultat i një analize për nevojën e plotësimit të strukturës organizative me staf të ri, gjatë kësaj periudhe janë graduar: 1 nënkolonel, 1 major, 2 kapiten dhe 127 togerë. Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë ndarë: 230 medalje për Shërbim të Besnikërisë, 4 medalje Mburojë e Policisë, 18 medalje për



Lëvdim, 26 Lëvdata dhe 21 Mirënjohje nga drejtori i Përgjithshëm.

Njëzet e një (21) vjetori i themelimit e gjen Policinë e Kosovës me njëzet e një (21) heronj, të rënë në kryerje të detyrës. Për këtë, presidenti i Republikës së Kosovës, dekoroi me urdhrin “Hero i Kosovës” 19 zyrtarë policorë të rënë në kryerje të detyrës.

Për mbështetjen e vazhdueshme e cila i është ofruar Policisë, drejtori i Përgjithshëm ka ndarë: 3 letërfalënderime për personelin e Shërbimit Spitalor dhe të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës; 1 letërfalënderim për Forcën e Sigurisë së Kosovës; 2 letërfalënderime dhe 2 pllaka policore për KFOR-in; si dhe 1 pllakë policore ish shefit të Misionit të OSBE-së, ambasadorit William WALKER.



Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Trajnimeve ka organizuar 31 trajnime për 1,003 pjesëtarë të saj dhe 47 ricertifikime për 499 zyrtarët policorë. Në bashkëpunim me organizata tjera janë organizuar 202 trajnime për 1,631 pjesëtarë të saj. Ndërsa, jashtë vendit janë organizuar 35 aktivitete (trajnime, takime, konferenca) për 75 zyrtarë policorë. Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike janë duke studiuar 93 zyrtar policor. Ndërsa 3 zyrtar policor vijnë studimet jashtë vendit.



Policia e Kosovës dhe Shoqata e Grave e Policisë së Kosovës në vazhdimësi promovon vlerat e Policisë së Kosovës në ngjarje të ndryshme, organizuar në nivel vendor dhe ndërkombëtar, me qëllim

të ngritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në adresimin e sfidave policore, me ç'rast ka organizuar Takimin Vjetor të Bordit të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police (IAWP), i cili është mbajtur nga data 07 – 08 mars 2020 në hotelin Emerald në Prishtinë, si dhe kanë organizuar konferencën ndërkombëtare “Roli i zyrtarëve policorë në reagim ndaj kërcënimeve transnacionale”, që është mbajtur nga data 09 – 10 mars 2020, në Prishtinë.

Takimi Vjetor i Bordit të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police (IAWP), është mbajtur për herë të parë në Ballkan në 105 vjet histori të kësaj shoqate policore prestigjioze që ka shtrirje po thuajse në të gjithë botën. Qëllimi i kësaj shoqate është të forcojë, të bashkojë dhe të rrisë kapacitetin e grave në polici ndërkombëtarisht (IAWP tani numëron 73 shtete të ndryshme të botës, ku përfshihen gjithsej 26 regjione).

Në takimin vjetor të bordit të mbajtur nga data 07 – 08 mars 2020 kanë marrë pjesë 27 anëtare nga shtetet e ndryshme të botës si nga: Amerika, Afrika e Jugut, Anglia, Kanada, Zelanda e Re, Trinidad dhe Tobago, Bangladeshi, Indonezia etj. Drejtues të këtij takimi kanë qenë presidentja e IAWP dhe anëtarët tjera të bordit drejtues. Takimi i bordit drejtues të IAWP dhe konferenca ndërkombëtare kanë qenë

të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Ambasada e SHBA-së në Kosovë-Programi INL dhe ICITAP.

Nga data 09 – 10 mars është mbajtur konferenca ndërkombëtare “Roli i zyrtarëve policorë në reagim ndaj kërcënimeve transnacionale”, ku kanë marrë pjesë mbi 200 pjesëmarrës nga institucionet e ndryshme të zbatimit të ligjit në Kosovë, anëtarët e bordit të shoqatës së grave police, përfaqësues të Policisë nga shtetet e rajonit të Shqipërisë, Malit të zi, Maqedonisë së Veriut, Sllovenisë etj. Në agjendën dyditore të konferencës janë paraparë zhvillimi i punimeve në panele të ndryshme, ku panelistë kanë qenë personalitete të niveleve të ndryshme: (a) ish presidentja e Republikës së Kosovës; (b) ministri i Punëve të Brendshme; (c) drejtori i Përgjithshëm i Policisë; (d) zëvendësambasadori amerikan; (e) shefja e Zyrës së BE-së; (f) menaxherja e Programit në ICITAP; (g) Avokati i Popullit; (h) përfaqësues nga misioni i OSBE-së në Kosovë, (i) kryetarët e shoqatës së Policisë dhe IAWP-së, (j) deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës; (k) përfaqësues nga Zyra për barazi gjinore e kryeministrit, si dhe (l) përfaqësues të ndryshëm të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë konferencë përveç tjerash nga ekspertë të fushave të ndryshme u diskutuan tema me rëndësi për sigurinë dhe rolin e femrave në polici, sfidat në rekrutimin e femrave në institucione të sigurisë dhe barrierat për avancimin e tyre, kuptimi i policimit të bazuar në gjini si mundësi për zhvillimin e përgjegjshmërisë gjinore në Polici, qasja policore e përqendruar tek viktimat gjatë proceseve si dhe menaxhimi i rasteve, rastet e dhunës në familje, trafikimi me qenie njerëzore, dhuna dhe abuzimi lidhur me teknologjinë dhe radikalizmin e dhunshëm si dhe tema të ndryshme.

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2020, ka pas në dispozicion buxhetin prej 114,338,928.49€. Për paga të punonjësve të Policisë janë shfrytëzuar shuma prej 91,988,941.63€, ndërsa në modernizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjeve policore janë shpenzuar 16,646,163.57€. Për shkak të rritjes së angazhimit të Policisë në planin operativ



për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19, brenda kësaj periudhe është vërejtur ngritja e harxhimit të derivateve për mjetet motorike të Policisë për 4.44%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Brenda kësaj periudhe janë iniciuar 113 projekte të prokurimit në vlerën prej 13,186.841.54 €. Prej 113 projekteve të prokurimit të iniciuara, 83 kanë qenë për furnizim, 18 për shërbim, ndërsa 12 për punë.

Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia e Kosovës monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar 1,348 lëndë disiplinore, prej tyre 719 lëndët e bartura nga vitet paraprake, ndërsa 629 lëndë të hapura gjatë vitit 2020. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 588, prej tyre 231 lëndë kanë qenë nga vitet paraprake, ndërsa 357 lëndë nga viti 2020. Nga gjithsej 588 lëndë të përfunduara, 248 lëndë kanë qenë me status të bazuar, 78 me status të paargumentuar, për 8 lëndë nuk ka veprim, për 251 lëndë kanë pushuar hetimet, ndërsa 3 lëndë janë kthyer në Inspektoratin e Policisë së Kosovës.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar 258 lëndë me 402 shkelës të supozuar, janë shqyrtuar 231 lëndë dhe janë nxjerrë 380 vendime disiplinore, ndërsa për trajtim për vitin 2021 kanë mbetur 115 lëndë disiplinore me 167 shkelës të supozuar.

Nga gjithsej 417 raste të cilat janë pranuar gjatë vitit 2020 dhe 37 raste kanë qenë të bartura nga viti paraprak, Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar 400 raste, prej të cilave: në 288 raste është konstatuar se ankesa ka qenë e pabazuar dhe vendimi mbetet

në fuqi; në 18 raste ankesa ka qenë e bazuar dhe e aprovuar; në 35 raste ankesa ka qenë pjesërisht e bazuar dhe vendimi ka qenë pjesërisht i ndryshuar; në 50 raste vendimi është kthyer në plotësim të hetimeve, ndërsa në 9 raste ankesa është hedhur poshtë sepse është parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar 7 auditime të rregullta, për të cilat janë dhënë 39 rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë. Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar 62 inspektime të rregullta si dhe 75 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 197 rekomandime.

Në vazhden e aktiviteteve të zhvillimit strategjik të Policisë gjatë kësaj periudhe:

- a) ka përfunduar faza e konsultimit paraprak të projektligjit për pensionimin e zyrtarëve policorë dhe i është proceduar ministrit të Financave për nënshkrimin e kostos;
- b) projekt ndryshim-plotësimi i Ligjit nr.03/L-118 për tubime publike është finalizuar, me ç'rast është përgatitur shkresa për dërgimin e këtij drafti për komente në Komisionin e Venecias;
- c) projekt ndryshim-plotësimi i UA nr.02/2018 mbi

Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës është në proces të finalizimit;

d) ka përfunduar procesi i hartimit të draft UA për përdorimin e kamerave të vëzhgimit në vendet publike, qëllimi i të cilit është: (i) Plotësimi i legjislacionit vendor dhe krijimi i një baze juridike më të fuqishme për përdorimin e pajisjeve policore për vëzhgim në vendet publike; (ii) Krijimi i rregullave dhe procedurave për përdorimin e kamerave për vëzhgim në vendet publike nga ana e Policisë; (iii) Kontrollimi dhe monitorimi i punës dhe veprimeve policore;

e) është përfunduar procesi i vlerësimit të realizimit të objektivave të parapara me planin zhvillimor strategjik të Policisë 2016-2020;

f) është themeluar grupi punues për hartimin e planit strategjik zhvillimor të Policisë 2021-2025, ku në kuadër të procesit të hartimit të planit zhvillimor strategjik 2021-2025, janë hartuar draft propozimet për objektivat strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet;

g) është hartuar dhe është aprovuar strategjia e integruar e Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi;

h) është themeluar grupi punues për hartimin e rregullores për integritet në Policinë e Kosovës dhe brenda kësaj periudhe është hartuar drafti i parë i rregullores;

i) është hartuar dhe është aprovuar procedura standarde e operimit (PSO) për procedimin e lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimeve;

j) janë azhurnuar PSO-të për Disiplinë, për Komisionin e Brendshëm Disiplinor dhe për Komisionin e Ankesave;

k) janë dhënë 5,213 komente juridike për verifikim të së kaluarës kriminale, janë dhënë 126 interpretimet ligjore, mendime profesionale dhe këshilla juridike, si dhe janë nënshkruar 42 marrëveshje bashkëpunimi.

Për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore dhe qartësimet ligjore në fushën e

politikës së ndëshkimit dhe shqiptimit të dënimeve ndaj personave fizikë dhe juridikë, të cilët i shkelin rregullat, vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, Policia është ballafaquar me vështirësi në zbatimin e vendimeve qeveritare, në parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Duke identifikuar zbrazëtira ligjore në politikën e ndëshkimit dhe shqiptimit të dënimeve, Policia ka arritur të kontribuojë në iniciimin e procedurës së hartimit të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, i cili autorizon Policinë në shqiptimin e dënimeve ndaj personave të cilët i shkelin rregullat, vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, me datën 27 korrik 2020 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (MPB) dhe EUROPOL-it, e cila ka për qëllim fuqizimin e kapaciteteve të Policisë në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit të rëndë. Përmes kësaj marrëveshjeje, është arritur që Policia e Kosovës të trajtohet në mënyrë të barabartë, sikurse edhe shërbimet policore të vendeve në rajon, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje të ngjashme me EUROPOL-in. Në të njëjtën kohë, një oficer ndërlidhës i Policisë së Kosovës pritet të dërgohet shumë shpejt në selinë e EUROPOL-it në Hagë.

Shëndeti i personelit policor ka qenë në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, adresohen dhe parandalohen



sëmundjet dhe dukuritë tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, ku gjatë kësaj periudhe, përveç angazhimit në parandalimin dhe luftimin e përhapjes së COVID-19 brenda Policisë, personeli i Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (DShSh) në kuadër të Policisë ka qenë po ashtu i angazhuar në:

- a) ofrim të përkrahjes shëndetësore ndaj zyrtarëve policorë me risk të lartë ndaj COVID-19;
- b) ofrim të përkrahjes psikologjike në menaxhimin e ankthit dhe panikut tek personeli policor, shkaktuar nga COVID-19, gjatë të cilit janë mbajtur 197 seanca psikologjike dhe 77 vlerësime psikologjike;
- c) ofrim të përkrahjes mjekësore për 4,987 pjesëtarë të Policisë;
- d) mbështetje të operacioneve policore me autoambulancë në 21 plane operative dhe 6 asistencë,
- e) fushatë e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGj), në të cilën kanë marrë pjesë 516 punonjës të Policisë.

Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit të modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me planin Strategjik të Zhvillimit për 2016-2020. Në kuadër të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara në ofrimin e qëndrueshmërisë: (a) Sistemi i Integruar Informativ i Policisë (SIPK); (b) Sistemi Informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS); (c) Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve (BIMS); (d) Sistemi i vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore; (e) Projekti 3D-GIS; (f) Implementimi i sistemit të ri për linjat emergjente 192; (g) Përmirësimi i Sistemit Telefonik VoIP;

Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën

e sigurisë rrugore, kundër përdorimit të drogave etj. Gjatë periudhës raportuese nga Policia:

- a) janë lëshuar 815 komunikata me shkrim për media;
- b) janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;
- c) janë publikuar 170 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;
- d) janë dizajnuar dhe janë publikuar 45 projekte policore;
- e) është hartuar dhe është publikuar revista e Policisë së Kosovës “MBROJTËSI” dhe
- f) janë publikuar vidiospote, broshura vetëdijesuese lidhur me aplikacionin e Policisë së Kosovës “Lajmëro Policinë”.

Duke marrë në konsideratë faktin se Policia e Kosovës udhëhiqet nga parimi i policimit demokratik dhe si rrjedhojë e kësaj transparence para shoqërisë dhe publikut në përgjithësi është esenciale për funksionimin e Policisë, gjatë kësaj periudhe është bërë ridizajnimi i web faqes së Policisë dhe lansimi i webit të ri (www.kosovopolic.com), i cili ka pasur 1,076,033 vizita brenda vitit. Ndërsa faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në rrjetin social ‘Facebook’ <https://facebook.com/Kosovopolic/> ka gjithsej 63,945 ndjekjes aktivë.

Ndër më të shikuarat në faqen zyrtare të Policisë së Kosovës në Facebook, kanë zënë postimet që kanë të bëjnë me shërbimin ndaj qytetarëve. Si rrjedhojë, pikërisht pas shkrimit i cili është postuar me 11 prill 2020, që ka të bëjë me një person të zhdukur, është realizuar një plan kërkimi për qytetarin B.O., në të cilin janë angazhuar 96 zyrtarë policorë nga njësi të ndryshme policore, përfshirë njësinë K-9 (njësia me qen). Ky shkrim ka arritur shikueshmërinë deri në 104,666 persona. Po ashtu, për këtë kanë reaguar, komentuar dhe e kanë shpërndarë informatën 4,833 persona.

Qytetarët kanë shfaqur interesim më të madh për lajmin i cili ka të bëjë me zyrtarin policor Sami THAQI i cili ka humbur jetën me datën 28 janar 2020, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në fshatin Zhur. Ky lajm ka prekur thellë ndjenjat dhe e kanë shikuar 199,863 persona dhe ka pasur mbi 2,8 mijë komente.



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE

PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL **APLIKACIONI ‘LAJMËRO POLICINË’**

MUNDËSI AL-
TERNATIVE E
KOMUNIKIMIT TË
QYTETARIT ME
POLICINË PËR
LAJMËRIMIN E
RASTEVE

GARANTIM
ANONIMITETI
DHE REAGIM
I SHPEJTË

APLIKACIONI
“LAJMËRO POLICINË”
ËSHTË PLATFORMË
ELEKTRONIKE

MUNDËSI
E DËRGIMIT
TË TEKSTEVE,
FOTOVE
DHE VIDEOVE

RAPORTO
NË 24 ORË



Lajmëro
Policinë

BASHKËPUNIM,
PARTNERITET,
TRANSPARENCË